ZOTI VETINFORMUES

"Zoti është Ai, i cili që nga lashtësia bën thirrjen "Unë jam" dhe thërret njerëzit drejt Vetes. [...] Nuk është absolutisht e vërtetë se komunikimi i Zotit nuk bëhet më dhe ka qenë vetëm në të kaluarën. Ne nuk vulosim fjalën dhe komunikimet e Tij duke i kufizuar ato në një kohë të caktuar. Pa dyshim, Ai ende është i gatshëm të pasurojë pafundësisht kërkimtarët përmes burimit të shpalljes, siç ka bërë më parë. Dyert e bekimeve të Tij edhe sot janë të hapura, siç kanë qenë më parë".

Hazret Mirza Ghulam Ahmed[as]
"Islami usul ki filosfi", "Ruhani Khezain" **vëll. 10, f. 366-367**

ZOTI I DHEMBSHUR, BURIM I DASHURISË

"Njerëzit që me të vërtetë besojnë te Zoti i Gjithëmëshirshëm dhe që kuptojnë shtrirjen e pakufishme të butësisë dhe të mëshirës së Tij, përulen me mirënjohje ndaj Tij. Ata ecin në tokë me përulësi të skajshme dhe kalojnë jetën duke përhapur butësi e mirësi. Ata nuk i shkaktojnë dëm askujt dhe, nëse të tjerët u afrohen të zemëruar e me vrazhdësi, u përgjigjen në mënyrë dinjitoze, me paqe e dashamirësi. Sharjeve ata iu përgjigjen vetëm me lutje dhe kështu, ata arrijnë të kultivojnë në vetvete cilësitë që burojnë prej Zotit të Gjithëmëshirshëm dhe të Dhembshur. Me fjalë të tjera, ata përpiqen të sjellin dobi dhe të bëjnë të mira për të gjithë".

Hazret Mirza Masrur Ahmed[as],
Revista *"The Review of Religions"*, **tetor 2013, f. 55**

Xhemati Musliman Ahmedia

Xhemati Musliman Ahmedia është një bashkësi muslimane, e themeluar në vitin 1889 nga Hazret Mirza Ghulam Ahmedi[as], i cili deklaroi se është Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu. Ardhja e tij në *kohë të mëvonshme* ishte parashikuar nga Profeti Muhammed[saas]. Qëllimi kryesor i këtij xhemati është që të largojë paragjykimet dhe keqkuptimet që i janë veshur Islamit gjatë rrjedhave të kohës dhe t'u tregojë njerëzve Islamin e vërtetë, që është paqësor, tolerant dhe i praruar me spiritualitet, i njëjti Islam që u përcoll dhe u praktikua edhe nga Profeti Muhammed[saas]. Duke iu shmangur fanatizmit të verbër, Xhemati Musliman Ahmedia dënon të gjitha format e dhunës dhe terrorit që kryhen në emër të fesë.

Ky xhemat, i përbërë nga dhjetëra milionë anëtarë, sot gjendet në më shumë se 200 vende të botës dhe konsiderohet si një prej bashkësive më dinamike brenda Islamit. Aktualisht ky xhemat udhëhiqet nga Hazret Mirza Masrur Ahmedi[aba], Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar.

Për pyetje rreth Islamit dhe Xhematit Musliman Ahmedia, ju lutemi na kontaktoni në numrin e gjelbërt. **0800 1889**
Ky komunikim pa pagesë (nga çdo numër fiks apo celular) funksionon çdo ditë të javës nga ora 08[00] - 20[00].

www.alislam.al

Shqipëri

Rr. "Pavarësia"
Mëzez, Tiranë
Kutia postare 8176
darulfalah@gmail.com

Kontaktoni:
+355 672168054
+355 662974992
+355 695876901

Kosovë

Rr. "Holger Pedersen"
Lagjja e Spitalit,
Prishtinë
amj.kosovo@gmail.com

Kontaktoni:
+377 44817813
+381 38558436
Fax: +381 38512408

Leaflet "God is Alive" in Albanian

ZOTI ËSHTË I GJALLË

Zoti flet edhe sot.
Bëhu dëshmitar i Zotit të Gjallë!

Kjo fletushkë informuese është pjesë e nismës për paqen "Muslimanët për lirinë, paqen dhe besnikërinë" të iniciuar nga Xhemati Musliman Ahmedia i Shqipërisë.

Xhemati Musliman Ahmedia
i Shqipërisë

Muslimanët që besojnë se Hazret Mirza Ghulam Ahmedi[as] është Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu

ZOTI I GJITHËMËSHIRSHËM

Çdo njeri është i lirë të zgjedhë rrugën që do, të mirë apo të keqe. Disa njerëz kanë përshtypje të gabuar se Zoti i Islamit ushtron forcë dhe detyra e Tij, sipas tyre, është të dënojë krijesat dhe t'i hedhë në ferr. E vërteta është që Krijuesi ynë nuk është diktator apo mbret tiran që t'i ndëshkojë krijesat e Veta.

> *"Sa i përket ndëshkimit tim, godas me të kë të dua, kurse mëshira Ime përfshin çdo gjë..."*
>
> Kurani Famëlartë 7:157

ZOTI I GJALLË

Islami e prin njeriun drejt Krijuesit të tij, të cilin e paraqet si Zot të Gjallë, që i dëgjon lutjet njeriut dhe ia pranon ato.

"Kur robërit e Mi të pyesin rreth Meje, Unë pa dyshim jam afër. I përgjigjem lutjes së lutësit, kur ai Më lutet. Prandaj, edhe ata le t'i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, që të udhëzohen".

Kurani Famëlartë 2:187

ZOTI I GJITHËDIJSHËM

Islami nuk është një fe që imponon ligjet, por përmes lejimeve dhe ndalimeve të tij, ai udhëzon njeriun që të arrijë sa më shpejt te Zoti i Madhërishëm.

> *"Mundet që ju të mos pëlqeni diçka, kurse ajo është e mirë për ju. Po ashtu, mundet që ju të pëlqeni diçka, kurse ajo është e dëmshme për ju. Allahu di dhe ju nuk dini".*
>
> Kurani Famëlartë 2:217

Qëllimi i krijimit të njeriut është që ai ta njohë Zotin dhe atributet e Tij e t'i pasqyrojë ato në jetën vet. Për këtë, ai duhet të balancojë dëshirat vetjake, të shijojë mëshirën dhe dashurinë e Zotit dhe, për hir të kësaj dashurie, t'u shërbejë krijesave të Tij.

DISA NGA ATRIBUTET THEMELORE TË ZOTIT

I Dhembshur

I Gjithëmëshirshëm

Mëshirëplot

Burim i paqes

Kujdestar

I Plotfuqishëm

Sundues

Siguridhënës

Nismëtar

Krijues

Formues

Madhështor

ZOTI, BURIMI I LUMTURISË

"Organet dhe aftësitë që ka njeriu, qofshin të brendshme apo të jashtme, që të gjitha synojnë t'i sigurojnë njohjen e Zotit, adhurimin dhe dashurinë e Tij. Kjo është arsyeja, që njeriu edhe pasi të jetë marrë me gjithfarë angazhimesh, prapëseprapë, lumturinë e vërtetë nuk e gjen asgjëkund, përveçse te Zoti. Edhe sikur të bëhet shumë i pasur, autoritar i fortë, tregtar i madh, sundimtar, filozof, ai largohet shumë i dëshpëruar nga kjo botë, pasi të lirohet nga prangat e saj. Zemra e tij gjithnjë e fajëson, për shkak të angazhimit të tij të verbër në çështjet materiale. Ndërgjegjja e tij asnjëherë nuk pajtohet me intrigat, mashtrimet dhe punët e tij të palejueshme".

Hazret Mirza Ghulam Ahmed[as], *"Islami usul ki filosfi"*, *"Ruhani Khezain"* vëll. 10, f. 415